

Thirrje për Ekspert Kombëtar

Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi – IDRA në Tiranë ka nevojë për zbatimin e projektit "Universitete pa korrupsion në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi" i cili zbatohet në kuadër të SMART BALKANS - SHOQËRI CIVILE PËR SHOQËRINË E PËRBASHKËT NË BALLKANIN PERËNDIMOR, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë shpall një thirrje për **PUNËSIM** të **EKSPERTI KOMBËTAR** për Raportin e Përbashkët, Dokumentin e Politikave, Udhëzuesin Kundër Korrupsionit dhe paketën e instrumenteve të praktikave më të mira, si dhe ofrimin e seminareve për ngritjen e kapaciteteve.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit: promovimi i shtetit të së drejtës, ofrimi i administrimit efektiv të drejtësisë dhe parandalimi i korrupsionit midis studentëve dhe punonjësve të universiteteve në sistemin e lartë të arsimit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

Objektivi(at) (rezultatet) specifike të projektit: (1) të rrisë ndërgjegjësimin e të gjitha palëve të në sistemin e lartë të arsimit për zbatimin efektiv të mekanizmave të parandalimit të korrupsionit; (2) për të forcuar kapacitetet e administratës dhe menaxhimit të universitetit, si dhe kapacitetet e studentëve, trupave studentore dhe organizatave për të zbatuar legjislacionin ekzistues për parandalimin e korrupsionit dhe për të zhvilluar instrumente të reja për të adresuar sfidat e shfaqura dhe (3) për të promovuar vendosjen e një mjedisi mundësues për raportimin e korrupsionit nëpërmjet aktorëve të mirë informuar dhe publikut të gjerë.

Fusha e Punës: Përgatitja e një metodologjie për përgatitjen e një raporti të përbashkët, një përmbledhje politikash, një udhëzues për parandalimin e korrupsionit me shembuj të praktikave më të mira së bashku me ekspertë kombëtarë nga Maqedonia e Veriut dhe Serbia dhe duke u konsultuar me ekipin e projektit.

- Ditët e parashikuara të punës për përgatitjen e Metodologjisë – 1 ditë

Raport i përbashkët për perceptimin e korrupsionit dhe vlerësimin e parandalimit të korrupsionit në Shqipëri, me qëllim të identifikimit të sfidave të mundshme në zhvillimin e aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve dhe veprimet e mundshme legjislative.

- Ditët e parashikuara të punës për përgatitjen e Raportit të Përbashkët – 4 ditë

Përmbledhje e politikave, për të ofruar konkluzione të sakta të operacionalizuara në rekomandime të konkrete për politikëbërësit dhe palët përkatëse të interesit.

- Ditët e parashikuara të punës për Dokumentin e Politikave – 1 ditë

Udhëzues për Parandalimin e Korrupsionit, mbështetur nga Paketa e praktikave më të mira të përshtatshme – me synimin për të përshkruar procedurën për mbrojtjen e të drejtave të studentëve në

mënyrë të thjeshtë bazuar në një qasje hap pas hapi në çdo vend. Udhëzuesit do të përmbajnë një përshkrim të detajuar hap pas hapi të procedurave që duhen ndjekur nga studentët dhe mjeteve juridike në dispozicion të tyre në çdo vend. Pakoja e mjeteve do të përmbajë një përmbledhje të praktikave më të mira në parandalimin dhe raportimin e korrupsionit dhe do t'u shpërndalet grupeve të synuara në të gjitha ngjarjet publike.

- Ditët e parashikuara të punës për Udhëzuesin për Parandalimin e Korrupsionit – 3 ditë

Ofrimi i dy seminareve njëditore me qëllim të forcimit të kapaciteteve të aktorëve të projektit me mekanizma efektivë për parandalimin e korrupsionit. Kurrikula e seminarit do të bazohet kryesisht në gjetjet e hulumtimit dhe në përmbledhjen e politikave.

- Ditët e parashikuara të punës për përgatitjen dhe organizimin e seminareve për ngritjen e kapaciteteve - 3 ditë (1 ditë për përgatitje dhe 2 ditë për realizim)

Gjithsej janë planifikuar 12 ditë pune për angazhimin e Ekspertit Kombëtar.

Në vlerësimin e ofertave do të përdoret një metodë e kombinuar e renditjes.

Plotësimi i kriterëve teknike – 70 pikë (Arsimi përkatës – 10 pikë; Master – 10 pikë; Doktoratura - 10 pikë; përvojë e mëparshme përkatëse - 20 pikë; Hulumtime të mëparshme të ngjashme - 20 pikë). Pragu i vlerësimit – 50 pikë.

Plotësimi i kriterëve financiare – 30 pikë. Numri maksimal i pikëve do t'i jepet propozimit me çmimin më të ulët në krahasim me ata ofertues që do të kalojnë prapun e pikëve gjatë vlerësimit të komponentit teknik (50 pikë). Të gjitha propozimet e tjera të çmimeve do të marrin pikë në përpjesëtim të zhdrejtë me çmimin më të ulët sipas formulës së mëposhtme:

Rezultati Max. për çmim propozimi * Çmimi i propozimit me çmim më të ulët

Rezultati për propozimin e çmimit X = -----

Çmimi i propozimit X

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në Juridik, master dhe doktoraturë do të konsiderohen si avantazh
- Të paktën 10 vjet përvojë pune në autoritet antikorrupsion, administratën publike, arsimin e lartë
- Përvojë në konsultim dhe punë me organe qeveritare dhe OJQ
- Përvojë pune me studentë dhe grupe të organizuara studentore
- Aftësi të forta kërkimore dhe analitike
- Përvojë pune në reformat lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve
- Të paktën tre kërkime që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fushën e antikorrupsionit, administratën publike, arsimin e lartë, aksesin në informacionin publik, mbrojtjes së sinjalizuesve, etj. në pesë vitet e fundit.
- Përvojë në punë me organizata ndërkombëtare ose në iniciativa dhe projekte rajonale



Mënyra e aplikimit: Kandidati dorëzon një CV, letër motivuese dhe ofertë financiare (tarifa totale bruto) në adresën e emailit blerta.kalavace@idra.al jo më vonë se 10 mars 2023.

Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, të gjithë kandidatët do të njoftohen për rezultatin.

Asnjë telefonatë ju lutem.

Tiranë,2023